



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.178 dt.27.11.1997

**PER  
DHENIE FOND PAGE PER PERSONELIN QE ADMINISTRON  
KAPITALIN SHQIPTAR TE CAM – TOYS SH.P.K.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen tij të dt.27.11.1997, shqyrtoi relacionin për dhënie fond page për personelin e shoqërisë CAM – TOYS paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Zhvillimit Industrisë. Mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.7, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të organeve të pushtetit lokal” pika.2, nëndarja”a”

**VENDOSI**

1. Personelit për ruajtjen e objektit, pjesë e kapitalit shqiptar në administrimin të Bashkisë, ti jepet çdo muaj fond të ardhurash për pagesën e drejtorit që i fillon nga 1 korriku 1997, 4 rojeve që i fillon nga 16 Tetori 1997 dhe financierit që i fillon nga 1 dhjetori 1997(për dy muaj) me pagat si më poshtë :

**Drejtori            7.200 lekë(Pagesa i fillon nga 1 Korriku)**

**Roje 4 x 5.000 20.000 lekë(Pagesa i fillon nga 16 Tetori)**

**Financiere            6.000 lekë(Pagesa i fillon nga 1 Dhjetori)**  
----- **deri më 31 Janar 1998.**

**Shuma            33.200 lekë**

**Sig. Shoqërore 34.2% = 11.354.4 lekë**

**Kompe.buke 250 x 6 = 1.500 lekë**

-----  
**Shuma totale      46.054.4 lekë**

2. Pagesa fillon sipas pikës 1 të sipërshënuar.
3. Pagesa do të vazhdojë deri në prishjen e shoqërisë dhe kthimin e pjesës shqiptare në ndërmarrje shtetërore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**